



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.3, datë 9/02/2024

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR SHFRYTËZIM UJI NËNTOKËSOR PËR QËLLIME FAMILJARE, TË Z. IDAJET AJDINI, ME VENDNDODHJE, NË LAGJEN “ALI DEMI”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për autorizim të z.Idajet Ajdini, “Kërkesë për autorizim për shfrytëzim uji nëntokësor për qëllime familjare (jo ujë të pijshëm, sasi <0.5 l/sek), me vendndodhje, lagjia “Ali Demi”, Bashkia Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH)

– X= 487450.46; Y= 4576571.36; Z=188 m.m.n.d;

- Prurja e ujit të kërkuar: $Q=0.4$ l/sek
- Thellësia e pus-shpimit: 120 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 90 m
- Prurja që shkarkohet: $Q=0.2$ l/sek
- Trupi ujqor pritës : Gropë septike

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

